PREFEKTURA DIBER
Arkiva
Nr. 630 di 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

Nr. 300/6 prot.

Peshkopi, më 24 .06 .2021

# VENDIM

**Nr. 12 Date 24 .06 .2021**

## "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS"

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 82/1, gërma "b" dhe neni 77, gërma "k", në mbështetje 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, Urdhërin Nr 187, datë 18.12.2020 " *Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar*" I ndryshuar me urdhërin nr 188, datë 18.12.2020 " *Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të e Rishikuar*", Kryesia e Këshillit të Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 24 .06.2021, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë "Për miratimin e progrtamit të transparencës", me 11(njëmbëdhjetë) vota pro:

## VENDOSI:

1. Të miratojë programin e transparencës të Këshillit të Qarkut Dibër.
2. Vendimi të dërgohet pranë Institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, date 24 .06.2021

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KËSHILLI I QARKUT DIBER -



Scanned by TapScanner

PREFEKTURA DIBËR
Nr. 629 Prot
dt. 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

Nr.300/5 Prot

Peshkopi më 24.06.2021

**VENDIM**

**Nr.11 Date 24.06.2021**

**PËR**

**PROPOZIMIT PËR PENSION TË POSAÇËM SHTETËROR PËR Z. FIQIRI AQIF RAMA.**

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77, neni 5 i Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (Ndryshuar), VKM nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Këshillit i Qarkut Dibër në mbledhjen e dates 24.06.2021, me kërkesë të sektorit juridik dhe të projekteve, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë "Miratim e propozimit për pension të posacëm shtetëror për z. Fiqiri Aqif Rama, me 12 (dymbëdhjetë )vota pro:

**V E N D O S I:**

1- Ti propozoj Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posacëm Shtetëror z.Fiqiri Aqif Rama, për arritjen të rezultateve të dallueshme në fushën e sportit.

2-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.

3-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.

4-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

5-U shpall me dt.24.06.2021.

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**

**Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al**

Scanned by TapScanner

PREFEKTURA DIBËR
Nr. 628 di 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

Nr. 304 prot.

Peshkopi, më 24 .06.2021

**VENDIM**

**Nr. 10 Date 24 .06 .2021**

**"PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR SHTESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR PËR Z.ISMAHIL SELMAN FARRUKU"**

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 82/1, gërma "b" dhe neni 77, gërma "ll", në mbështetje Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet Shoqërore në Republiken e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 5, gërma "b". Në zbatim të VKM Nr.429 datë 12.09.2002, "Për kushtet e përfitimit dhe proçedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore" pika 4, Këshilli i Qarkut Diber në mbledhjen e datës 24 .06.2021, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë "Për miratimin e propozimit për shtesë pensioni të posaçëm Shtetëror për z..Ismahil Selman Farruku, me 11(njëmbëdhjetë) vota pro:

**V E N D O S I:**

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave, miratimin e kërkesës për shtesë pensioni të posaçëm shtetëror për Z.**Ismahil Selman Farruku.**

2. Vendimi të dërgohet pranë Institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori Juridik e Projekteve.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

5. U shpall sot, date 24 .06.2021

**KRYETAR**

**Valentina Halili**

Adresa : Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al

Scanned by TapScanner

PREFEKTURA DIBËR
627 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

Nr. 300/3 prot. Peshkopi, më 24.06.2021

**VENDIM**

**Nr. 9 Datë 24.06.2021**

**PËR**
**MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KRYESISË SË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR**

Mbështetur në pikën 5 të nenit 72, në gërmat "dh"; "n" të nenit 77 dhe gërmën "b" të nenit 82 të Ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar në gërmën "c", neni 5, të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", në Ligjin nr.9936, dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"", i ndryshuar; në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 4, dt. 25.01.2021 "Për zbatimin të buxhetit 2021", në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 03, datë 18.09.2019 "Për zgjedhjen e Kryesisë së Këshillit të Qarkut Dibër", dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut Nr. 21 datë 21.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021", Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 24.06.2021, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë, me **12 vota** pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shpërblimit mujor të Anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut në masën 10% të pagës bruto së Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibër.
2. Efeketet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 01.01.2021, deri në një vendim të dytë
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës
4. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë
5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.
6. U shpall sot më datë 24.06.2021

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**

Adresa : Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al

Scanned by TapScanner

626 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT
DIBËR

Nr. 300/2 prot.

Peshkopi, më 24.06.2021

# VENDIM
Nr. 8, date 24.06. 2021

## "PËR
## MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE ARTISTIKE, KULTURORE, SOCIALE , SPORTIVE E PROMOVUESE PËR VITIN 2021"

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 77, gërma "k", neni 82, gërma "b", në VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore,artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 24.06.2021, pasi shqyrtoi projektin e Kryesisë "Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve artistike, kulturore, sociale , sportive e promovuese për vitin 2021" me **11 (njëmbëdhjet) vota pro**,

## V E N D O S I :

1. Të miratojë kalendarin e aktiviteteve artistike, kulturore, sociale, sportive e promovuese për vitin 2021 sipas **lidhjes 1** që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Aktivitetet e mësipërme do të organizohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë me pjesëmarjen, në disa raste në bashkëpunim, me Këshillin e Qarkut.
3. Për aktivitetet e përbashkëta me bashkitë ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
4. Vendimi ti dërgohet institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë
5. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Kabineti i Kryetarit dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
7. U shpall në Peshkopi, sot datë 24.06.2021

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KËSHILLI I QARKUT DIBER -



Scanned by TapScanner

PREFEKTURA DIBER
Arkiv
Nr. 625 dt. 28.06.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT DIBËR**

Nr. 300/1 prot.

Peshkopi, më 24 . 06.2021

# VENDIM

**Nr. 7 Datë 24 . 06.2021**

## PËR
## MIRATIMIN E PROJEKT-DOKUMENTIT TE PARE TE PBA 2022-2024

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", në gërmat "dh"; "n" të nenit 77, nenit 72 dhe nenit 82 germa "b", Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise te Financave nr.2, date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar", Udhezimit te Ministrise te Financave nr.7, date 26.02.2021 "Per pergatitjen e PBA 2022-2024", pika I/12, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 24 .06.2021, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë, me 13 vota pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e e projet-dokumentit te pare per programin buxhetore afatmesem 2022-2024", sipas tabelave bashkengjitur.
2. Vendimi te dergohet prane Institucionit te Prefektit per verifikimin e ligjshmerise.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot më dt 24.06.2021

**KRYETAR**

**Valentina Haliti**

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al

Scanned by TapScanner